



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
INSTITUCIONET E PËRKOHSHE TE VETËQEVERISJES
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA



MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
MINISTRIA PËR EKONOMI DHE FINANCA
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE

DEPARTAMENTI I THESARIT

MANUALI I THESARIT

Kuponat e Ditarit



VËLLIMI II

SHTOJCA

QERSHOR 2007

Manuali i Procedurave për Shfrytëzuesit e Sistemit

Kuponat e Ditarit

Për përdorim nga Thesari Qendror, Zyrat Regjionale të
Thesarit
dhe të gjitha MKA-të

Maj 2007

Korrigjuar më 7 maj 2007, Versioni 1.0

INDEKSI

1. Objektivi
2. Fushëveprimi
3. Autoriteti
4. Rrjedha e punëve/Skema e rrjedhës së procesit – Kuponat e Ditarit
5. Dokumentet burimore
6. Regjistrimet në SIMFK
7. Raportimi i SIMFK-së
8. Shtojcat – Shtojca A -Formularet

1. Objektivi

Ky dokument ka për synim të përshkruaj procedurat për regjistrimin e të dhënave në Ditar nga koha e verifikimit të vlefshmërisë së regjistrimit në ditar (në lidhje me dokumentet burimore) në sistemin SIFMK.

Regjistrimet në ditar të përshkruara në këtë procedurë kanë të bëjnë me rregullimet, korrigjimet dhe anulimet e shpenzimeve dhe të hyrave, përfshirë këtu edhe funksionet e listës së pagave.

Në këtë pjesë **NUK** përfshihen proceset e regjistrimit të të dhënave në Ditar në lidhje me veprimet bankare dhe rregullimet e pasqyrës së bilancit. Këto regjistrime bëhen nga Thesari dhe diskutohen në një procedurë të ndarë.

Procesimi i regjistrimeve në ditar është pjesë përbërëse e sistemit të përgjithshëm për menaxhimin e shpenzimeve. Është specifik për politikat dhe procedurat financiare kontabël të Qeverisë së Kosovës. Si në rastin e seksioneve tjera të këtij manuali, edhe këtu fillohet me një pasqyrë skematike të procesit e pastaj secili hap i procesit diskutohet në hollësi, ku theksohen ekranet dhe miratimet e nevojshme për secilin hap.

2. Fushëveprimi

Kjo procedurë është në interes të:

- Ministria, Komuna, Zyrtarët Certifikues të Agjencive Qeveritare
- Raportimi Financiar Qeveritar - Thesari


3. Autoriteti

Kjo procedurë mbështet në paragrafët e Rregullores nr. 2003/17 për Shpalljen e ligjit të miratuar nga Kuvendi i Kosovës për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si më poshtë:

- Neni 16, Llogaritë në Fondin e Konsoliduar të Kosovës

4. Rrjedha e punëve/Skema e rrjedhës së procesit – Kuponat e Ditarit

Përgjegjësia



5. Dokumentet burimore

Ky dokument përshkruan dokumentin burimor të njohur si Kërkesa e Përgjithshme për Regjistrim në Ditar e cila përdoret nga MKA-të (Ministritë, Komunitat dhe Agjencitë Qeveritare) dhe njësitë për Raportim Financiar Qeveritar për të hapur dhe miratuar një regjistrim të rregulluar ose të anuluar si përgatitje për regjistrim në sistemin SIMFK.

Aktualisht përdoren dy forma në mënyrë të këmbyshe dhe të ndërlidhur. Për shkak të kësaj, në këtë procedurë do të përdoret Kërkesa e Përgjithshme për Regjistrim në Ditar e paraqitur në faqën e radhës.



Njësia për Raportim Financiar Qeveritar pranon njoftimin nga MKA-të për rregullimin e llogarive. Njësia Raportuese gjithashtu bën identifikimin dhe rregullimet. Pavarësisht, njësia pranon një kopje në letër të plotësuar të Kërkesës së Përgjithshme për Regjistrim në Ditar e cila është e paraqitur në faqen në vijim. Para regjistrimit në FreeBalance duhet të bëhet verifikimi i fushave si më poshtë:


1. Viti
2. Blloku kodues
3. Shuma e debitit
4. Shuma e kredituar
5. Përshkrimi i regjistrimit
6. Kërkuar nga
7. Autorizuar nga

Me rastin e regjistrimit në atëherë në formularin në letër plotësohen fushat në vijim:

8. Regjistruar në SIMFK nga
9. Numri i Kuponit të Ditarit – caktuar automatikisht nga sistemi SIMFK

Shënim: në disa raste bëhet Ruajtje e Përkohshme në sistemin SIMFK. Kjo zakonisht bëhet pasi që shfrytëzuesi mund t'a ruaj përkohësisht regjistrimin para se ta regjistroj dhe ta ruaj në sistem. Kjo mund të bëhet për shkak të dhënave jokomplete ose për shkak të të dhënave për të cilat nevojiten hulumtime të mëtejshme.

 UNMIK	PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT INSTITUCIONET E PËRKOHSHE TE VETËQEVERISJES PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLJANJA MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE DEPARTAMENTI I THESARIT	
Kërkesë për regjistrim Kupon Ditari		
<input type="checkbox"/> Kthim i fondeve		0 0 1 7 7 9
<input type="checkbox"/> Refuzim para pagese		Numri i KD
<input type="checkbox"/> Tjetër		2 0 0 7
Të dhënat e stornimit		Viti
Numri i KSH/KD		Nr i zotimit:
<input type="checkbox"/> Shuma totale KSH/KD	Shuma që duhet të stornohet:	€
<input type="checkbox"/> Shumë e pjeshme	Shuma që duhet të stornohet:	€
Për kthime të pjeshme: Ju lutem tregoni shënimin kontabël të kërkuar nëse përfshihen më shumë se një kod ekonomik.		
4 1	2 0 1	1 1 2 0 1
		6 5 0 0 0
		9 4 1 0 9
		0 1 1 2
		3,150 Euro
4 1	2 0 1	1 1 2 0 1
		5 7 0 0 0
		9 4 1 0 9
		0 1 1 2
		3,150 Euro
Arsyetimi: Te regjistrohen te hyrat e Grandeve qe nuk kane ardhur akoma nga donatori.		
Kërkuar nga:	Autorizimi:	Departamenti i kontabilitetit:
Emri: XHEVAT HASOLLI	Emri: NYSRET KOCA	Emri: HALIME NISHEVCI
Nënshkrimi:	Nënshkrimi:	Nënshkrimi:



6. Regjistrimet në SIMFK

Në këtë seksion paraqiten hapat për regjistrimin e të dhënave në sistemin financiar SIMFK. Këtu përfshihen foto të ekraneve, referencat dhe shpjegimet.




Hapi i parë për shtimin e një Regjistrimi në Ditar është që të hapni dritaren e kuponave të ditarit. Për ta bërë këtë:

1. Klikoni në “Libri i Pergjithshem”
2. Klikoni në “Kuponat e Ditarit”

Automatikisht do të shfaqet ekrani “Kuponat e Ditarit” i cili është i paraqitur në faqën në vijim:

Vëni re se ekrani do të jetë në formën e kërkimit ("Kërko").



Kliko butonin komandues “Shto” – vëni re se me këtë forma e ekranit do të ndryshohet nga “Kërko” në “Shto” siç është paraqitur në faqën në vijim. Kjo është e nevojshme për të shtuar një evidentim të Kuponit të Ditarit.

Do të shfaqet ekrani kryesor "Kuponat e Ditarit" siç është paraqitur në faqën në vijim.

Në ballinë do të vëreni se të gjitha fushat plotësohen automatikisht përfshirë këtu:

Lokacioni - paraqitet 1 si standard


Viti Fiskal - si standard paraqet vitin e tanishëm fiskal

Periudha - si standard paraqet muaji i tanishëm

Burimi - si standard paraqet “Manual”


Nr. i Kuponit - SIMFK-ja automatikisht cakton numrin e kuponit të radhës në dispozicion

Data - SIMFK-ja automatikisht cakton datën aktuale



Nr. i Përkoh. – siç është përmendur më herët, sistemi SIMFK cakton një numër të përkohshëm në mënyrë automatike në rast se shfrytëzuesi nuk dëshiron të ruaj të dhënat në bazën e të dhënave. Kjo është e dobishme në rastet kur procedohet ndonjë regjistrim i gjatë dhe shfrytëzuesi dëshiron ta ndërprej procesimin, mirëpo dëshiron t'i ruaj informatat e regjistruara deri në atë moment. Për të bërë një ruajtje të përkohshme klikoni në sustën komanduese "Veprim" në shtyllën e epërme të veglave dhe pastaj klikoni në "Ruajtje Përkoh.".

Në ekranin kryesor të Kuponave të Ditarit klikoni në kutinë rënëse e cila gjendet afër fushës "Përshkrimi" dhe shkruani përshkrimin në gjuhën shqipe, angleze dhe serbe. Kliko në "Prano" për t'u kthyer në ekranin kryesor të Kuponave të Ditarit.



Në ekranin Kuponi i Ditarit shkruani bllokun kodues nga dokumenti burimor. Kliko në fushën e bllokut kodues dhe shfaqet ekrani "Blloku Kodues" i dhënë në faqën në vijim.

Tabela	Kodi	Përshkrimi
Fund Objective	41	WB-BANKA BOTËRORE
Principal Unit	201	MINISTRIA E EKONOMISE
Sub - Program	11201	ADMINISTRATA DHE IT - THESAR
Line Item	57000	TË HYRAT-GRANDET E PAPERANUARA
Sub-Project	94109	WB PUBLIC EXPEND MANAGEMENT
Class	0112	ÇËSHTJET FINANCIARE DHE FISKAL

#	Zoti./Oblig.	Biloku Kodues	Shuma	Detaj.	Përsht
1		41/201/11201/57000/94109/0112	0.00		

Regjistrimi i dytë i bllokut kodues të kërkuar është dhënë më lartë. Shkruani numrat kodues drejtpërdrejtë nga dokumenti burimor si më lartë. Kliko në “Prano” për t’u kthyer në ekranin kryesor të Kuponëve të Ditarit. Më poshtë është dhënë ekрани i Kuponit të Ditarit të plotësuar.

FreeBalance

Dosja Edito Aksioni Kërko Iabelat Shërbimet ShkoTe

Kuponat e Ditarit

Pastro Shto Ruaje Edito Fshije Gjeje << >> Zoom Shtyp Dalja

MEF - FMDTRN Kuponat e Ditarit

Shto

Lok: 1 VF: 2007 *Prd: 6 Burimi: MANUAL Kuponi #: AUTONUM Data: 2007-06-14

Statusi i dërg. # i përk. Arsyja e pa dërguar # i Grupit

Përshkrimi: Te hyra te pa parapara PENTAG Dokumenti Burim # Shënimet e Balancimit

Forma e Pagesës Lokacioni Zyra e Llog. Mbaje Për prd.tj

0001

Artikujt

#	Zoti./Oblig.	Elloku Kodues	Shuma	Detaj.	Përsh.
1		41/201/11201/57000/94109/0112	3,150.00		
2		41/201/11201/57000/94109/0112	-3,150.00		

Debitet: 3,150.00 Kreditë: 3,150.00 Totali: 0.00


Kodet e Shfrytëzuesve Aprovimi 1 Nga Aprovimi 2 Nga Data Data

Përfundo regjistrimet dhe pastaj klikoni në Ruaje. Nëse shuma e debive dhe kredive nuk është e barabartë me zero atëherë sistemi SIMFK nuk do të lejoj ruajtjen. Në SIMFK duhet të evidentohen regjistrime të balancuara të ditarit. Nëse Kuponi i Ditarit është një e dhënë e përbërë atëherë shtoni linja shtesë për kodim duke vendosur kursorin në cilën do prej fushave “Nr. i Artikullit” dhe pastaj duke klikuar në “Shto”.

7. Raportimi i SIMFK-së

Në këtë seksion përshkruhen raporte të ndryshme të sistemit SIMFK që janë në shfrytëzim. Pas ruajtjes së Kuponit të Ditarit atëherë sistemi SIMFK gjeneron raportin e hollësishëm të Kuponit të Ditarit. Për të hapur këtë raport ju duhet të:

1. Klikoni në “Libri i Përgjithshëm i Llogarive”
2. Klikoni në “Raportet”
3. Klikoni në “Raportin e Detajizuar i Kuponëve të Ditarit”



Ekрани "Raporti i Hollësishëm i Kuponëve të Ditarit" do të shfaqet ashtu siç është paraqitur në faqen në vijim.

Në mënyrë që të nxirret Raporti i Hollësishëm i Kuponëve të Ditarit duhet të bëhen veprimet në vijim:

1. Periudha – Siguroini që ju e caktoni periudhën e duhur për kuponin tuaj të ditarit. (Sistemi SIMFK e paraqet si standard periudhën e tanishme).
2. Nr. i Kuponit – Vendosni numrat e kuponit në fushat “Nga” dhe “Deri”.
3. Klioni në “Opcionet e Daljes” – kjo ju mundëson të shikoni raportin në ekran apo ta ruani atë në një dosje.

Raporte të tjera që mund të ekstrahohen nga sistemi në të njëjtën mënyrë të treguar më sipër janë:

- Raporti I Analiza të Llogarive- Permbledhje
- Raporti I Analizave të Llogarive – Detaje.


8. Shtojcat

Ky seksion përfshin të gjithë shtesat e duhura.

Shtojca A – Formularet

Formularet e treguar më poshtë në këtë procedurë përfaqësojnë formularet zyrtare të qeverisë dhe mund të nxirren nëpërmjet faqe elektronike të Ministrisë:


<http://www.mfe-ks.org/English/mefwww/departamentet/thesari/formularet.html>



PROFESSIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
 INSTITUCIONET E PËRKOMBASHTË MIT QILIMBERGJES
 ПРОВЕРЖЕННЫЕ ИНСТИТУТЫ СВОБОДНОГО РАБОТНИКА

MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE
 MINISTERIA E EKONOMISE DHE FINANCOVE VE
 МИНИСТЕРСТВО ЭКОНОМИКИ И ФИНАНСОВ

DEPARTAMENTI I THESARIT



Formulari i hërke të rregullitimit të përkuponit ditari

[][][][][]	Hu-më i zakonit	[][][][][]	Hu-më i KD
[][][][][]	Hu-më i KD të përmbledhimit	2 0 0 6	Qilim

Kuponët e përmbledhimit të ditës dorëzohen për KD me më shumë se 1 qestër.

[][]	[][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][]	[][][]	Shuma: [] [] [] [] [] [] €
	Debit / Kredit:						
[][]	[][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][]	[][][]	Shuma: [] [] [] [] [] [] €
	Debit / Kredit:						
[][]	[][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][]	[][][]	Shuma: [] [] [] [] [] [] €
	Debit / Kredit:						
[][]	[][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][]	[][][]	Shuma: [] [] [] [] [] [] €
	Debit / Kredit:						
[][]	[][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][][]	[][][][]	[][][]	Shuma: [] [] [] [] [] [] €
	Debit / Kredit:						

Acordimi:

SHIH DOKUMENTACIONINE EMBASHANGJITUR

E hërkuar nga:		Auditorja/imi:		Departamenti i hërkeve ditare:	
Emri:	Sokol Bexho	Emri:	Nysret Koca	Emri:	Halime Nishevd
Mënyshkrimi:		Mënyshkrimi:		Mënyshkrimi:	
Data:	29.02.2007	Data:	29.02.2007	Data:	29.02.2007

A. Luteri, kryetar i Komitetit të Kontrollit të Ditarit

